

Akt Themelimi

I shoqerise tregtare "MC&C ALBANIA" SH.P.K.

Mbeshtetur ne Kushtetuten dhe Kodin Civil ne Fuqi te Republikes se Shqiperise , ne ligjin Nr.7512 date 10.08.1991 "Per sanksionimin dhe mbrojtjen e prones private, nismes se lire dhe te veprimtarise private dhe privatizimit", te ligjit Nr. 9901 date 14.04.2008, "Per shoqerite tregatre" dhe te ligjit Nr.9723 , date 03.05.2007 "Per Q.K.R dhe formalitetet qe duhen respektuar nga Shoqerite Tregtare, me vullnetin e tyre te lire, te shprehur edhe ne nenshkrimin e ketij akt-themelimi, une ortaku z. Antonio Vincenzo Moshetta, me nr. ID CA88209AU krijoj shoqerine tregtare me pergjegjesi te kufizuar "MC&C ALBANIA" SH.P.K. me akt themelimi si vijon :

Formulimi

Neni 1

Sot me date 15.10.2018, formohet shoqeria tregtare private e quajtur "MC&C ALBANIA" SH.P.K. Shoqeria do ti nenshtrohet legjislacionit Shqipetar, ndersa deget qe mund te krijohen do ti nenshtrohen legjislacionit ku do te kete seline dega. Shoqeria do te ushtroje veprimtarine e saj ne baze te ketij akti themelues dhe statutit te shoqerise qe do te miratohet nga ortaku themelues.

Selia e Shoqerise

Neni 2

Selia e shoqerise ndodhet ne adresen: Ne Kavaje, Lagja nr.2, Bulevardi Josif Budo, e ndodhur ne zona kadastrale nr.8551, pasuria me numer 4/368+2-2. Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj, te hape zyra perfaqesie, dege, te krijojte filiale si brenda ashtu dhe jashte Republikes se Shqiperise, vetem me vendim te asamblese dhe ortakeve te saj.

Objektivi i Veprimtarise

Neni 3

Shoqeria do te kryejë aktivitetin e mëposhtëm:

Import-Eksport artikuj industrial dhe ushqimore.

Mbareshtimin, prodhimin, tregjetimin me shumice dhe pakice, perpunimin e dritherave, farave te cdo lloj natyre dhe fruti, tregjetimin e plehrave kimike, produkteve per mbrojtjen e bimeve, pesticideve, dhe te cdo lloj produkti te dobishem per bujqesine.

Shitjen per llogari te vet dhe te treteve te kafsheve te seleksionuara, produkteve shtazore, ushqimeve per kafshe, si dhe te gjitha llojet e produkteve qe lidhen me kultivimin, prodhimin dhe shitjen e produkteve ushqimore organike, te drejten e ndermarrjeve bujqesore me vehte dhe me qera.

Ofrimi i sherbimeve teknike, konsulente te cdo lloj sherbimi lidhur me blegtorine dhe bujqesine, mirembajtjen e paisjeve per blegtori e bujqesi.

Zhvillimin, projektimin, ndertimin e centraleve te energjise hidroelektrike, termoelektrike, dhe burimeve te rinovueshme, shitjen e energjise elektrike, trajnimin e personelit dhe realizimin e kurseve te kualifikimit, agjenci tregtare, ndermjetes dhe perfaqesues te personave fizike dhe juridike shqiptare dhe te huaj ne vend dhe jashte vendit, aktivitet komisioner, spedition, transport te brendshem dhe nderkombetar, logjistike, agjensi mobilare dhe imobilare, ndertim kapanonesh industriale dhe ndertime te llojeve te tjera, si dhe cdo lloj aktiviteti qe nuk ndalohet nga ligji.

Kohezgjatja e Shoqerise

Neni 4



Kohezgjatja e shoqërisë do të jetë me një afat të pacaktuar. Ajo mund shpërbehet në çdo kohë dhe për çfarëdo lloj shkak.

Kapitali i Shoqërisë

Neni 5

Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 100.000 lekë (njëqind mijë) Lekë.

1. Ortaku themelues z. Antonio Moschetta: Zoterues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 100.000 (njëqind mijë leke) që përben 100 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Drejtimi i Shoqërisë

Neni 6

Shoqëria do të drejtohet nga administratori i saj z. Antonio Moschetta, i cili do të jetë dhe përfaqësuesi ligjor i saj. Ai është përfaqësuesi i Shoqërisë në marrëdhënie me të tretet dhe ka kompetencë të plota në drejtimin e saj.

Cdo kontratë do të kryhet prej tij dhe në rast mungese nga një përfaqësues i pajisur me prokurë të posaçme.

Neni 7

Të ardhurat neto të shoqërisë i takojnë ortakut.

Neni 8

Ortaku ka të drejtë të emerojë dhe administrojë të tjerë të vlerave materiale.

Ka të drejtë të caktojë financiare, likuidator për problemet e shoqërisë si dhe të pajtojë persona të tjerë si ortakë.

Neni 9

Konfliktet që mund të lindin do të zgjidhen në zbatim të legjislativës Shqiptare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë.

Neni 10

Shoqëria ka vulën e saj me madhësi të zakonshme, me tekstin rreth saj.

Neni 11

Shoqëria deklarohet e krijuar në zbatim të plotë të normave të statutit dhe në përputhje me legjislativën Shqiptare në fuqi dhe vecanerisht të Ligjit Nr.9901 datë 14.04.2008 "Për Krijimin e Shoqërive Tregtare", si dhe duke zbatuar ligjet ndërkombëtare dhe të vendit si dhe rregullave që zbatohen për biznesin që kryen kjo shoqëri .

Neni 12

Akti i themelimit u perpilua në 2 kopje, për t'ju shpërndarë organeve kompetente dhe një kopje do të mbetet në dokumentacionin bazë të shoqërisë "MC&C ALBANIA" SH.P.K.

Akti i themelimit nënshkruhet rregullisht nga ortakut.

Ortaku themelues:

Antonio Moschetta

